

## Si funksionon: „Praktika provuese“?

### 3 ditë në jetën e Abelit dhe Mirjamit

Ia dola! Abeli në kohë të saktë kalon portën kryesore të ndërmarrjes Mechatronic AG dhe i iu drejtua zotërisë prapa barit me shkresën „Pritja“. „Quket Abel Monteiro dhe duhet të lajmërohej këtu, ai do të nis sot një praktikë provuese,“ i tha ai zotërisë me kostume. Ky i hodhi një shikim ekranit të tij dhe iu përgjigj me mirësjellje: „Po, juve janë duke ju pritur. Ju lutem uluni dhe pritni pak. Zoti Braun do të vijë menjëherë për t’ju pranuar“.

### Përshtypja e parë

Në qoshe tashmë ishte ulur një vajzë, e cila ishte përafërsisht e moshës së Abelit. „A ke ardhur edhe ti për të bërë praktikë provuese?“, pyeti ajo pa ndruajtje. „Po. Edhe ti?“ „Sigurisht, ndoshta dua të bëhem konstruktore.“ Në atë çast erdhi një zonjë e re te ata: „Ti duhet të jesh Mirjam Rulic?“, iu drejtua ajo vajzës. „Unë jam Lisa. Jam në vitin e tretë të mësimit të profesionit (zanatit) për konstruktore dhe do të përkujdesem për ty gjatë praktikës provuese.“ Të dyja ia ia zgjatën dorën njëra-tjetrës për përshëndetje dhe shkuan drejt ashensorit. Sapo u zhdukën ato, një i ri me mbiveshje me ngjyrë të kuqe ecte me hapa të shpejt drejt tij. „Tungjatjeta Abel. Unë quhem Braun. Unë do të përkujdesem për ty gjatë praktikës provuese“. „Mirëmëngjesi zoti Braun.“ „Këtu e ke kartelën tënde. Eja, duhet të shkojmë andej në një ndërtesë tjetër“. Ata kaluan te një derë rrotulluese, e cila u hap vetëm pasi Abeli e vuri kartën e tij pranë sensorit të derës.

### Ushtime praktike

Në një vidhëmbërthyes Abeli gërryente një mbajtëse të baterisë të një llambe dore, nga e cila ai nën instruksionet e zotit Braun, ka çmontuar pjesë të ndryshme, kur në fabrikë vijnë Lisa dhe Mirjami. „Ju jeni takuar tashmë në sallën e pritjes. Këtu prodhohen pjesët e veglave, të cilat ne i planifikojmë në Departamentin e Konstruksionit“, shpjegon Lisa. „Me polimekanikët diskutojmë p.sh. sa kohë nevojitet për të mbaruar një porosi, domethënë sa do të kushtojë prodhimi.“

Abeli tashmë është duke përpunuar një llambë dore, të cilën e kemi si pjesë ushtrimi edhe në programin e konstruksionit“. Pasdite zoti Braun i tregoi Abelit punën me makinën për shpim. Abeli sa do të fillonte me shpimin e vrimave të para në mbajtësen e baterisë, erdhi zoti Braun me Mirjamin te ai. „Prit edhe pak, kemi vërejtur se mbajtësja e baterisë është shumë e gjatë, dhe nëse duam që bateritë të kenë kontakt të pastër, duhet ndryshuar. E kemi përshtatur planin. Duhet t’i marrësh matjet e reja“. Abeli i buzëqeshi Mirjamit: „Nuk ka Problem!“

### Më mirë pyet se të prishësh

Sapo u largua Mirjami, ai kërruset mbi planin e ri. Djall o punë, si e kemi bërë sot edhe njëherë në mëngjes shenjzimin? Ai e rrotulloi planin në disa anë dhe e krahasoi me mbajtësen e tij. Së fundi i mori të dyja në dorë dhe shkoi te zoti Braun në anën tjetër, ku ai ishte duke programuar një Torno CNC. I tregoi atij për ndryshimet e bëra nga Mirjami dhe nuk dinte se si e kishin filluar montimin e mbajtësve. „Mirë që ke ardhur për të pyetur në vend se të shposh vrima kudo“, i tha zoti Braun. „Askush nuk pret prej teje të jesh i aftë që herën e parë të bësh diçka. Dhe kjo ndodh shpesh që Departamenti i Dizajnit më vonë të bëjë ndryshime. Për këtë arsye duhet të tregojmë fleksibilitet. Shiko, këtë mëngjes këtu e ke krijuar vijën bazë...“

Pak para orës 17:00 zoti Braun shkoi te Abeli: „Edhe pak mbaron orari i punës. A i shpove të gjitha vrimat?“ „Po, edhe pse për përgatitjen e sërishme kam pasur nevojë për më shumë kohë dhe më është dashur të ngutem për t’i shpuar vrimat. Por, nuk do të harroj kaq shpejt si duhet bërë këtë“. Zoti Braun i kontrollloi vrimat e shpuara dhe i rrahu shpatullën në shenjë mirënjohje Abelit. „Mirë duket“, e lavdëron ai. Mirupafshim nesër. Tashmë e di si duhet hyrë në ndërmarrje. Mos e harro kartelën!“ „Mirupafshim zoti Braun dhe faleminderit që më keni sqaruar edhe njëherë“, përgjigjet Abeli.

## Shënimet ndihmojnë

Në stacionin e autobusit ai e takoi Mirjamin. „Më ke stresuar mjaft me ndryshimet tua Mirjam!“ „Nuk kam dashur, më vjen keq. Por Lisa ka dashur të më testojë, nëse e kam bërë planin mirë. Pastaj është dashur ta shkruaj të tërën në ditarin e praktikës provuese.“ Tash i ra ndërmend Abelit: Mësuesja e tij e kishte këshilluar të shkruante gjithçka kishte bërë, dhe si i kishte pëlqyer puna. Për shkak të të gjitha ndryshimeve, a e kishte harruar plotësisht atë. „Sonte do të kem si duket detyra shtëpie me ditarin tim të praktikës provuese“, ofshau ai. „Edhe, i ke bërë të gjitha detyrat e shtëpisë?“ e ngacmoi Mirjami Abelin të nesërmen, kur ai mori autobusin në Lindenplatz. „Po, prandaj edhe më ka zënë gjumi përpara televizorit. Kjo kurrë nuk më ka ndodhur më parë, qëndrimi i gjatë në këmbë më ka lodhur. Edhe këtë e kam shkruar pastaj.“ „Kam shënuar, se mund të paramendoj mirë, ku ka ndodhur gabimi në mbajtësen e baterisë dhe se duhet punuar më me shumë kujdes në kompjuter me rastin e përshtatjes së planit.“

„Kur e bën sot pushimin e drekës?“, pyeti Abeli duke zbritur. „A takohemi në kantinë?“ „Ende nuk e di saktësisht dhe SMS nuk mund të dërgoj. Celularin guxojmë ta përdorim vetëm gjatë pushimit dhe pas përfundimit të orarit të punës“, mendonte Mirjami. „Ndoshta rreth orës 12.30? Lisa pauzën e drekës e bën gjithmonë më vonë“.

Paraditja e dytë në Mechatronic AG kalon shpejt. Abeli i ka bërë të gjitha shpimet dhe pastaj ka mundur të shikojë se si zoti Braun e ka gërryer pjesën e prodhuar. Para drekës ai ka pasur kohë madje edhe për të bërë shënime në ditarin e mësimin provues. Mirjamin nuk e ka takuar në Kantinë, aty ka ngrënë drekë me zotin Braun dhe dy polimekanikë të tjerë. Tashmë prapë ishte në punë. Në një bankë me vegla (torno të vjetër) i tregoi zoti Braun si mund të dridhte një valë, pastaj edhe ai mund të provojë vetë. Goxha e vështirë, nëse dy duart duhet të bëjnë lëvizje të ndryshme. „Koni i Abelit nuk është drejtuar menjëherë, por këto gjëra ai do t'i mësojë“, pohonte zoti Braun. „Sidoqoftë, i pashkathët nuk është“. Abeli pyeti zotin Braun nëse guxonte të bënte një foto të tornos së vjetër me telefonin e tij celular për ditarin e tij të praktikës provuese. „Posi, ky është me siguri një përdorim i dobishëm i celularit“, i tha zoti Braun dhe Abeli mundi të fotografonte edhe një turjelë elektrike (Bohrmaschine), me të cilën kishte punuar dje.

## Komunikimi dhe bashkëpunimi

Në ditën e tretë autobusi nuk erdhi: Abeli u vonua për në punë! Për fat të mirë, zoti Braun ia kishte dhënë numrin e tij të celularit. Abeli i telefonoi menjëherë. „Mos u brengos, Abel, edhe unë kam mbetur i ngujuar, ata kanë shumë probleme, siç duket. Mirëpo, ke bërë mirë që ke telefonuar, është shumë me rëndësi që të komunikojmë me njëri-tjetrin.“ Më në fund arriti në ndërmarrje, zoti Braun i tregoi si të bënte prerjen e një fije. Pastaj Abeli iu desh t'i priste të dyja fijet e llambës së tij të dorës. Këso pune të saktë Abeli kurrë nuk kishte pasur nevojë të bënte. Pasi bëri montimin e llambës së tij të dorës, u dukën Mirjami dhe Lisa. Ajo duhet të shohë se si funksionon e tëra. Abeli ishte krenar, kur hynte mbajtësja e baterisë duke rrëshqitur pastër në tub. Gjatësia ishte e saktë dhe llamba ndriçonte pa lëkundje të kontaktit. Zoti Braun e lavdëroi punën e tij të saktë, dhe të katërt shtrëngojnë duart, sepse kanë bashkëpunuar mirë. Pasdite zoti Braun e analizoi me Abelin praktikën provuese. „Kam qenë i kënaqur me mënyrën si ke punuar. Kam vërejtur si punon me kujdes dhe kjo më ka pëlqyer. Mund të paramendoj, se ti mund të bëhesh një polimekanik i mirë“, ishte i mendimit zoti Braun. „Lajmërohu te ne, nëse kërkon një vend për mësimin e profesionit. Puna jote e saktë më ka bindur.“

Edhe Mirjami mori lëvdata prej Lisës: „Mënyra se si e ke paramenduar mbajtësen e baterisë ka qenë për mrekulli, dhe ti problemin e ke vënë nën kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të shkathët. Për konstruktore të tilla kemi nevojë!“

Kësaj radhe Abeli e priti Mirjamin në stacion të autobusëve. „Duhet të shkosh menjëherë në shtëpi? Apo do të mund të flasim edhe pak? Ne mund të shkojmë te liqeni?“, propozoi Abeli. „Më vjen keq Abel. Sepse në ora 18:30 kam ushtrime në hendboll. Por, të shtunën pasdite ne mund të shkojmë në kinema.“ „Ide e mirë“, u gëzua Abeli, „Shihemi rreth orës 16:00 përballë Abatonit?“ „Dakord, kalofsh mirë me detyrat e shtëpisë“, bëri shaka Mirjami dhe zbriti prej autobusit në Lindenplatz. „Athua janë të gjitha konstruktoret kështu të pakomplikuara?“ i shkoi një mendim nëpër kokë Abelit. E hapi ditarin e tij të praktikës provuese dhe tashmë e dinte se çka do të shënonte sapo të arrinte në shtëpi.